



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 prill 2012
Nr. ref.: RK224/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI161/11

Parashtruesi

Milan Petrović

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Ac. Nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Milan Petrović nga Prizreni, që e përfaqëson avokati Ymer Koro po ashtu nga Prizreni

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. Nr. 2/2011 i 10 qershorit 2011 që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 gusht 2011, me të cilën vërtetohet vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ndr. Nr. 302/10 i 23 nëntorit 2010 dhe refuzohet propozimi i parashtruesit të kërkesës për njohjen e kontratës së shitblerjes Leg. Nr. 1255/99 të 25 qershorit 1999 i vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd si aktvendim i shtetit të huaj.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011, duke mos precizuar nenet konkrete të Kushtetutës të cilat janë shkelur, por nga kërkesa mund të konstatohet se objekti i çështjes është çështje pronësore në të cilën parashtruesi i kërkesës konsideron se: "...rasti i kontratave në kontest duhet të trajtohet si aktvendim i shtetit të huaj, konkretisht të shtetit të Serbisë dhe Gjykata duhet të pranojë edhe këtë kontratë si aktvendim i shtetit të huaj".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20,22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe Rregullin 56 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës më 10 dhjetor 2011 në Prizren me anë të postës, ka dorëzuar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e cila është regjistruar në Gjykatë më 13 dhjetor 2012.
6. Më 27 janar 2012 Gjykata Kushtetuese informoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, për iniciimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit për lëndën nr. KI 161/11.
7. Më 19 prill 2012 pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Ivan Čukalović (kryesues), Iliriana Islami, dhe Gjyljeta Mushkolaj kanë paraqitur rekomandimin, para Gjykatës në përbërje të plotë, për papranushëmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar, në Gjykatën e Qarkut në Prizren, propozimin për njohjen e kontratës së shitblerjes së banesës Leg. Nr. 1255/99, të vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd më 25 qershor 1999, me të cilën parashtruesi ka blerë banesën e kontestuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme në Prizren, që ishte pronar i kësaj banese, banesa e përmendur gjendet në Prizren, por e njëjta kontratë është vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd për shkak të rrethanave që kanë ndodhur pas intervenimit të NATOS.
9. Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktvendimin Ndr. nr. 302/10 të 23 nëntorit 2010, hodhi poshtë propozimin e parashtruesit si të pabazë duke marrë parasysh se kontrata nuk përmbushë kushtet e parapara me Ligjin për zgjidhjen e konflikteve të Ligjeve me rregulloret e shteteve tjera, Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 43/1982 që me nenin 86 parasheh:

„Vendimi i gjykatës së huaj barazohet me vendimin e Gjykatës së Republikës Federale të Jugosllavisë dhe prodhon efekt juridik në Republikën Federale të Jugosllavisë, vetëm nëse e pranon Gjykata e Republikës Federale të Jugosllavisë.”

„Vendim i gjykatës së huaj sa i përket paragrafit 1 të këtij neni konsiderohet pajtimi i arritur në gjykatë (pajtim gjyqësor).”

„Vendim i gjykatës së huaj konsiderohet edhe vendimi autoriteti tjetër që gjendet në shtetin ku është lëshuar, i barazuar me vendimin gjyqësor respektivisht me pajtimin nëse me të rregullohen raportet e parapara me nenin 1 të këtij ligji”.

10. Ndaj këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës me vendimin Ac. Nr. 2/2011 hodhi poshtë propozimin e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ndr. Nr. 301/2010 të 23 nëntorit 2010, duke arsyetuar vendimin si vijon:

“...nuk janë përmbushur kushtet për njohjen e kontratës së shitjes së banesës si palë e huaj, sepse kontrata e ngjashme nuk mund të trajtohet si një urdhër i gjykatës e as si marrëveshje gjyqësore ashtu si supozon propozuesi në ankesën e tij”.

Pretendimet e parashtruesit

11. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011, duke theksuar se:

“Në territorin e Kosovës vazhdimisht kemi raste, dhe atë me qindra raste, kur qytetarët e Kosovës i drejtohen Gjykatës së Qarkut si kompetente për njohjen e vendimeve të shteteve të huaja në shtetin e Kosovës, dhe atë më së shumti vendimeve gjyqësore për prishjen e martesës dhe deri më tash çdo vendim i tillë është trajtuar si vendim i huaj dhe si të tillë edhe Gjykatat kompetente e kanë pranuar.

“Poashtu edhe rasti i kontratës kontestuese duhet të trajtohet si vendim i shtetit të huaj konkretisht të shtetit të Serbisë, dhe Gjykata duhet të pranojë edhe këtë kontratë si vendim i shtetit të huaj”.

“Krahas gjithë kësaj parashtruesi i kërkesës konsideron se i janë shkelur të drejtat që i përkasin në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për këtë propozohet që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të aprovojë këtë kërkesë si të bazuar dhe me vendimin e vet të vlerësojë dhe konstatojë se aktvendimet e paraqitura në këtë kërkesë janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe si të tilla të anulohen”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të Punës të Gjykatës.
13. Kërkesa e parashtruesit është në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës, mënyra e llogaritjes së afateve kohore përcaktohet me Rregullin 27 pikat 3 dhe 6 të Rregullores së Punës të cilat parashohin si në vijim :

“3. Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë të muajit me ditën gjatë të cilës k ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;”

“6. Përndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.”

14. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

15. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis* , Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr 30544/996, par. 28, Gjykata Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut [GJEDNJ] 1990-I).
16. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr 53363/99 të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk pohon se në çfarë mënyre neni 22 dhe Karta Sociale Evropiane e vitit 1996 mbështesin kërkesën e tij, ashtu siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
17. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre , kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064 të 30 qershorit 2009).
18. Përfundimisht kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Ai ka dështuar të theksojë dhe mbështesë me dëshmi se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
19. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës që parasheh: “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 pika 2 dhe Rregullin 36(2b) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 19 prillit 2012, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani